



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

**ANALIZA E TREGUESVE TË VEPRIMTARISË MËSIMORE PËR
VITIN AKADEMIK 2015-2016 NË UNIVERSITETIN
“ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN**

Dhjetor 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Analizën për veprimtarinë e kryer gjatë vitit akademik 2015-2016 po e zhvillojmë duke patur parasysh një strukturë të caktuar për problematikat në vijim.

1. Kushtet e realizimit të veprimtarisë për të cilën zhvillohet kjo analizë
2. Synimet dhe objektivat bazë për vitin akademik 2015- 2016
3. Problematikat nga analiza e veprimtarisë së kryer në njësitë bazë dhe njësitë kryesore, (departamentet, qendrat dhe fakultetet) të Universitetit “A. Xhuvani”
4. Treguesit, drejtimet dhe dinamika e veprimtarisë akademike
5. Përfundime dhe rekomandime

1. Kushtet e realizimit të veprimtarisë për të cilën zhvillohet kjo analizë

Gjatë vitit akademik 2015-2016, veprimtaria akademike është realizuar në disa kushte dhe zhvillime të veçanta:

- Zbatimi i Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Zhvillimi i procesit zgjedhor dhe zgjedhjet për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, datë 20.04.2016.
- Aplikimi i kritereve të reja të pranimit dhe regjistrimit të maturanëve në programet e studimit të arsimit të lartë.
- Verifikimi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit i kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani”.
- Aplikimi dhe realizimi me sukses i vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm institucional për procesin e akreditimit të Universitetit “A. Xhuvani”.

2. Synimet dhe objektivat bazë për vitin akademik 2015- 2016

Synimet dhe objektivat e gjithë veprimtarisë janë të lidhura dhe dalin në dukje nëpërmjet analizës dhe trajtimit të disa elementeve të punës mësimore dhe kërkimore në Universitetin “A. Xhuvani” si vijon:

- Programet e studimit, përmirësimi cilësor dhe rinovimi i tyre
- Realizimi i ngarkesës mësimore
- Niveli i mësimdhënies, kurrikulat dhe kontrolli i njohurive
- Stafi akademik dhe kualifikimi i tij
- Infrastruktura, kapacitetet mjedisore për veprimtarinë akademike
- Bashkëpunimi i strukturave dhe organeve drejtuese të Universitetit, në nivele rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

- Disiplina e punës etj.

3. Problematika nga analiza e veprimtarisë së kryer në njësitë bazë dhe njësitë kryesore, (departamentet, qendrat dhe fakultetet) të Universitetit “A. Xhuvani”

Universiteti “A. Xhuvani” përbëhet nga pesë njësi kryesore ose pesë fakultete; 25 njësi bazë ose 22 departamente dhe 3 qendra kërkimore.

Problematika të trajtuara në njësitë bazë të Fakultetit Ekonomik

Elementët e analizës së punës mësimore të njësive bazë të Fakultetit Ekonomik, janë shtrirë në disa drejtime kryesore si programet e studimit, realizimi i ngarkesës mësimore, niveli i mësimdhënies, zhvillimi dhe mbarëvajtja e provimeve, puna kërkimore shkencore, kualifikimi shkencor i stafit akademik, disiplina në punë, bashkëpunime, projekte, infrastruktura etj.

Fakulteti ofron 8 programe studimi të ciklit të parë, 11 programe studimi të ciklit të dytë, master i shkencave dhe master profesional.

Nga evidentimi i problematikave me kurrikulat, janë propozuar ndryshime të cilat i kanë shërbyer një qasjeje më të mirë ndaj tregut dhe ndaj përvojës më të mirë të programeve të ngjashme në universitetet perëndimore.

Programet e studimit administrohen nga pesë departamentet, stafi i të cilëve mbulon pjesën më të madhe të ngarkesës në auditor.

Personeli akademik me 43 pedagogë, 31 kanë tituj dhe grada shkencore.

Për vitin akademik 2015-2016, ngarkesa mesatarisht 70% është përballuar nga stafi akademik i brendshëm.

Ngarkesa mësimore në auditor është realizuar plotësisht për çdo lëndë. Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bërë duke marrë në konsideratë kritere të tilla si: titujt akademikë dhe gradat shkencore, fushat e kualifikimit, kërkimet shkencore të fushave përkatëse, botimet, etj.

Duke qenë se niveli i kualifikimit të stafit akademik është rritur, kjo ka bërë që të ketë një shpërndarje më të mirë të ngarkesës mësimore, duke reduktuar numrin e pedagogëve të ftuar në nivelin master, në krahasim me vitet e mëparshme.

Niveli i mësimdhënies është rritur ndjeshëm, e lidhur kjo me përvojën dhe kualifikimin në vijimësi të personelit akademik.

Literatura e përdorur, ciklet e leksioneve dhe tekstet e lëndëve janë miratuar paraprakisht në departamente.

Përsa i përket procesit të zhvillimit të provimeve, ai ka patur një mbarëvajtje normale.

Kualifikimi shkencor i pedagogëve të fakultetit ka patur një ecuri tepër pozitive. Duhet të kemi parasysh që pa një punë kërkimore shkencore të një niveli të lartë cilësor, nuk mund të realizojmë një mësimdhënie me përmbajtje cilësore.

Disiplina në punë është një element thelbësor që duhet të reflektohet detyrimisht në procesin e mësimdhënies.

Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të sotëm akademik (mësimor dhe kërkimor) është edhe pjesëmarrja në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë këtij viti akademik, ka patur mobilitete stafi dhe studentësh në kuadër projektesh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Ka patur aplikime dhe pjesëmarrje në projekte të ndryshme, duke shfrytëzuar të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit, për të përsosur metodat e mësimdhënies, përmirësimit të kurrikulave, kualifikimit të stafit dhe rritjes së cilësisë

Një tjetër domosdoshmëri është bashkëpunimi me fakultete e departamente të tjerë brenda vendit, me pushtetin vendor, institucionet e administratës publike, me shoqatat dhe me bizneset, ku janë mirëpritur studentët tanë për praktikat mësimore.

Infrastruktura, biblioteka, pajisjet laboratorike dhe teknologjike, kanë nevojë për përmirësime të vazhdueshme. Ngritja e zyrës për këshillimin e karrierës, do t'i shërbejë lidhjes së studentëve me tregun e punës.

Sfida jonë për këtë vit akademik, do të jetë rritja e autoritetit të diplomës që lëshon struktura jonë universitare.

Problematika të trajtuara në njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Humane

Fakulteti i Shkencave Humane ka shtatë njësi bazë.

Programet e studimit që ofrohen në këtë fakultet janë: 12 programe studimi bachelor, 2 programe studimi master profesional, 5 programe studimi master i shkencave dhe "Doktoratë në albanologji" me dy profile: histori dhe gjuhësi.

Në FSHH, aktualisht japin mësim 71 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 34 kanë tituj dhe grada shkencore.

Veprimtaria është fokusuar në zbatimin e programeve të studimit, në përpjekjen për përmirësimin e tyre, plotësimin e dokumentacionit mësimor të përvitshëm, përcjelljen dhe përmbushjen e udhëzimeve etj.

Për vitin akademik 2015-2016 u planifikua dhe u realizua me sukses pjesëmarrja aktive në një sërë aktivitetesh shkencore si p.sh. botime, prezantime, seminare kualifikimi apo konferenca, brenda dhe jashtë vendit, prej një pjese të konsiderueshme të pedagogëve tanë.

Është me përparësi edhe organizimi i ditëve të hapura për t'i sensibilizuar maturantët. Këtë vit mbetet sfidë organizimi i këtyre veprimtarive, duke qenë se do të vihet në zbatim një tjetër skemë e zgjedhjes së maturantëve prej universiteve.

Në lidhje me mjediset ku zhvillohet procesi mësimor, duhet theksuar se numri i sallave në dispozicion të departamenteve është ende i pamjaftueshëm.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe procesit të plotësimit në kohë të regjistrave dhe dorëzimit të tyre në sekretari, realizimit të marrëveshjeve të punës, si dhe firmosjes së evidencave të orëve mësimore.

Lidhur me ecurinë e provimeve, janë dhënë udhëzimet përkatëse për zhvillimin e tyre, për plotësimin dhe dorëzimin e procesverbaleve brenda afateve kohore.

Mbetet sfidë për vitin që vjen vlerësimi i performancës së pedagogut dhe reflektimit të këtij vlerësimi në procesin mësimor dhe në përzgjedhjen e stafit akademik.

Programet mësimore për vitin akademik 2015-2016, janë realizuar, por janë hasur edhe probleme. Departamentet duhet të nxisin doktorantët për përfundimin sa më shpejt të disertacionit doctoral dhe përfundimin e këtij cikli.

Një element shumë i rëndësishëm, i cili qëndron në thelbin e punës së stafit akademik është cilësia e mësimdhënies, përmirësimi i literaturave përkatëse të cikleve që mbulojnë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Rezultatet e provimeve dhe cilësia e studentëve pasqyrojnë nivelin e përfshirjes së studentëve në procesin mësimor në auditor që në fillimin e vitit akademik. Dokumentacioni të plotësohet me korrektësi nga strukturat.

Në vijimësi të orientohet puna më mirë për hartimin e programeve të reja mësimore (syllabuse); pasurimin e dokumentacionit të departamenteve; vlerësimin e performancës së pedagogut; nxitjen e procesit të kualifikimit të stafit akademik; puna për përzgjedhjen dhe cilësinë e studentëve etj.

Problematika të trajtuara në njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike ka 6 programe studimi bachelor; 2 programe studimi master profesional dhe 2 programe studimi master i shkencave.

Në FSHMT vijojnë studimet rreth 2000 studentë dhe numri vazhdon të jetë në rritje; është bërë zgjedhje e parë për shumë maturan të jo vetëm të Qarkut të Elbasanit, por edhe nga qarqet e tjera.

Rol kanë edhe ditët e hapura me maturan të shkollave të mesme duke i njohur me programet e studimit dhe mundësitë e punësimit në tregun e punës.

Nga bashkëpunimi shumë i mirë me universitete dhe institucione të ndryshme vendase e të huaja, stafi dhe studentët kanë patur mundësi që të përftojnë prej tyre ndër vite.

Konsolidimi i programeve të studimit Infermieri e Përgjithshme dhe Infermieri Mami (por edhe në programet e tjera të studimit të hapura me vonë) ka ardhur gjithmonë në rritje.

Kualifikimi i personelit akademik ka qenë prioritet i fakultetit.

Sigurimi i cilësisë së procesit mësimor është i lidhur me përgatitjen akademike, përvojën praktike në mësimdhënie, botimin e teksteve mësimore, kualifikimet në fusha që janë të lidhura me lëndën ku jep mësim, përdorimin e teknologjisë, bibliotekën, labororet, qendrën e teleinfermierisë (një investim i USAID), bazën materiale etj.

Në kuadër të cilësisë së procesit mësimor rëndësi të madhe ka zhvillimi i praktikave profesionale, nëpërmjet të cilave aftësohen studentët për profesionin e tyre.

Mjediset e Fakultetit janë më se të mjaftueshme për procesin mësimor; shfrytëzohen edhe mjediset e Qendrës Spitalore “Dr.Xhafer Kongoli”, të Spitalit psikiatrik “Sadik Dinçi”, të qendrës “Balashe” Elbasan etj.

Kurrikulat në vijimësi janë përmirësuar, duke patur parasysh problematikat kryesore në praktikën e përditshme mjekësore nëpërmjet lëndëve më gjithëpërfshirëse dhe duke shmangur gradualisht ato lëndë të cilat ishin shumë specifike; të gjitha këto në funksion edhe të tregut të punës.

Sigurimi i cilësisë së procesit mësimor në vijimësi ngelet prioritet dhe është i lidhur me pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve në veprimtari kërkimore shkencore; përmirësimin cilësor të planeve dhe programeve mësimore; hapje e programeve të reja, ulje e ngarkesës së pedagogëve duke rritur numrin e stafit; përmirësimin e infrastrukturës në procesin mësimor dhe rritjen e kapaciteteve të saj; përmirësimin dhe standardizimin e dokumentacionit mësimor; aktivizimin e studentëve; bashkërendimin e strukturave të ndryshme etj.

Problematika të trajtuara në njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës

Gjatë vitit akademik 2015-2016 Departamentet dhe Dekanati, me qëllim organizimin dhe funksionimin sa më të mirë dhe bashkëkohor, kanë propozuar dhe përgatitur modalitete dhe struktura



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

sa më efektive, të cilat shprehin drejtimet kryesore jo vetëm për ndarjet lëndore, por edhe drejtimet e veprimtarisë akademike e kërkimore-shkencore dhe në vijimësi përmirësimin e punës sipas kërkesave dhe standardeve.

Veprimtaria e FSHN është orientuar dhe bazuar në planin strategjik të zhvillimit të fakultetit, planet dhe programet mësimore, cilësinë e personelit akademik etj.

FSHN ofron 5 programe studimi bachelor, 4 programe studimi të ciklit dytë prej të cilëve 2 janë master i shkencave dhe 2 master profesional dhe një program studimi jouniversitar.

Për vitin akademik 2015-2016 veprimtaria mësimore ka qënë e orientuar në thellimin dhe përmirësimin e punës në disa drejtime si: rishikimi dhe realizimi i planeve mësimore të programeve të studimit; përmirësimi i çdo kurrikule mësimore dhe hartimi i kurrikulave të reja; shpërndarja e ngarkësës mësimore; ruajtja, pasurimi dhe përmirësimi i infrastrukturës mësimore; problematika e frekuentimit, vlerësimi gjithëvjetor i njohurive dhe zhvillimi i provimeve etj. Veprimtaria mësimore e lidhur me veprimtarinë shkencore dhe kërkimore (janë kryer analiza të veçanta), ku vlen të përmenden pjesëmarrja në vijimësi në disa veprimtari të tilla si seminare, konferenca ndërkombëtare, projekte etj.

Personeli akademik i Fakultetit përbëhet nga 46 vetë ku 35 janë më grada dhe tituj; rreth 90 vetë personel akademik i ftuar dhe me kohë të pjesshme, si dhe nga personeli ndihmës mësimor.

Veprimtaria akademike në strukturat e FSHN, është orientuar dhe do të orientohet drejt sfidave të zhvillimit të Arsimit të Lartë duke u bazuar në disa objektiva më specifike për zhvillimin e Fakultetit si hapjen e programit të doktoraturës, përmirësimin e infrastrukturës etj.

Problematika të trajtuara në njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave të Edukimit

Fakulteti përbëhet nga 5 njësi bazë; personeli akademik është 49 veta nga të cilët 33 janë me tituj dhe grada shkencore; ka një infrastrukturë të mjaftueshme në funksion të programeve të studimit, salla mësimi, laboratore etj.

FSHE ofron 26 programe studimi, 7 programe të ciklit të parë bachelor, 19 programe të ciklit të dytë master profesional dhe master i shkencave.

Në vijimësi është punuar për përditësimin ose reformimin e programeve ekzistuese, kryesisht të ciklit të dytë master, me qëllim përputhjen e tyre me kërkesat e Ligjit të ri të AL dhe tregut të punës.

Strukturat kanë rritur në vijimësi përgjegjësinë për cilësinë e materialeve lëndore dhe literaturës që u shpërndahet studentëve në kuadër të programit disiplinor.

Faktorë të tjerë që kanë ndikuar dhe pasqyruar në cilësinë e mësimdhënies janë edhe ngarkesa mësimore, kualifikimi i stafit akademik në fushën e mësimdhënies në sistemin universitar, veçanërisht të pedagogëve më të rinj; dixhitalizimi i procesit të mësimdhënies; zhvillimi i praktikave mësimore; zhvillimi i provimeve lëndore, mbrojtja e diplomës etj.

FSHE ka ndjekur një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj.

Gjatë vitit akademik 2015-2016, është rritur niveli i bashkëpunimit me universitetet brenda dhe jashtë vendit për projekte të përbashkëta. Veprimtarinë e vet FSHE e orienton drejt mundësive për përmirësimin e infrastrukturës së kërkimit dhe kushteve të mësimdhënies në të gjithë elementët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

përbërës të saj (mjediset për personelin akademik, shërbime për studentët etj.); për promovim të stafit të spikatur në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor.

FSHE shpall si vijon prioritetet e zhvillimit: programe studimi cilësore dhe në përputhje me nevojat për punësim dhe standardet e kërkuara; mësimdhënie që synon përmirësimin e nivelit të arritjeve të studentëve dhe diplomimin e tyre në kohë; infrastrukturë cilësore etj.

4. Treguesit, drejtimet dhe dinamika e veprimtarisë akademike

Të dhëna për programet e studimit

Në Universitetin “A. Xhuvani” ofrohen programe studimi për fusha dhe drejtime të ndryshme si vijon:

- Programe studimi të ciklit të parë (bachelor) – 39 programe studimi.
- Programe studimi të ciklit të dytë – 46 programe studimi (29 programe master profesional dhe 17 programe master i shkencave).
- Programe studimi të ciklit të tretë (doktoratura) – 2 programe studimi.

Në programet e mësipërme për vitin akademik 2015-2016 vijuan studimet mbi 11000 studentë gjithsej, por duke llogaritur edhe numrin e studentëve të sistemit me kohë të pjesshme, programet e studimit frekuentohen nga rreth 13 000 studentë (tabela 1).

Tabela 1. Numri i studentëve dhe kapacitetet pritëse

Fakulteti	Numri i studentëve për vitin akademik 2015-2016 dhe kapacitetet pritëse						
	Viti i parë	Viti i dytë	Viti i tretë	Gjithsej	Pa vitin e fundit	Të pritshëm për vitin 2016-2017	Kapacitete pritëse për vitin 2016-2017
FSHN	544	451	492	1487	860	530	1390
FSHH	751	683	1213	2676	1351	740	2091
FSHE	1072	1056	389	2487	1467	1640	3107
FE	1028	887	488	2403	1579	1460	3079
FSHMT	814	851	747	2362	1248	1160	2408
TOTALI	4209	3928	3329	11415	6505	5530	12075

Për vitin akademik 2016-2017 pati mbi 18 000 aplikime për të vijuar programet e studimit të ciklit të parë në Universitetin e Elbasanit. Senati akademik i Universitetit, bazuar në Ligjin Nr. 80 /2015 datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimet e njëjësive kryesore, përcaktoi në muajin shkurt kriteret e pranimit për studentët e ciklit të parë të studimit si vijon:

- Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimet e maturës shtetërore, në masën 50% (mesatare e thjeshtë).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

- Nota mesatare e gruplëndëve (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët), të përzgjedhura nga fakultetet për çdo program studimi të ciklit të parë, në masën 50%.

Formula e llogaritjes së pikëve është si më poshtë:

-Për programin e studimit Edukim fizik e sporte: (nota mesatare/10 x 50 + (pikët e konkursit/70x50).

-Për të gjitha programet e studimit: (nota mesatare/10 x 50 + (nota mesatare e gruplëndëve/10x50).

Regjistrimet në ciklin e parë të vitit akademik 2016-2017, janë me tregues sasiorë dhe cilësorë të kënaqshëm (tabela 2, figura 1).

Studentë të regjistruar gjithsej janë 2779 ose 87.61% e kuotave të kërkuara.

Theksojmë se në nivel kombëtar studentë të regjistruar gjithsej janë 22.963 nga 27.600 aplikantë ose 83%. Në universitetet publike janë regjistruar 18.584 ose 81% e totalit të të regjistruarve; ose 67% e aplikantëve.

Tabela 2. Regjistrimet në ciklin e parë të vitit akademik 2016-2017

Nr.	Fakulteti	% Regjistrimi	Kuota	Regjistrime				R4	Total	Të lira
1	Fakulteti i Shkencave Humane	87.89	644	163	153	152	98	566	78	
2	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	82.53	435	106	107	108	38	359	76	
3	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	94.31	703	205	145	161	152	663	40	
4	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	87.96	575	181	101	115	103	500	75	
5	Fakulteti Ekonomik	87.79	815	170	176	223	122	691	124	
	Totali	87.61	3172	825	682	759	513	2779	393	




Figura 1. Paraqitja grafike e regjistrimeve në ciklin e parë të vitit akademik 2016-2017

Në lidhje me kuotat e lira, pra mosrealizimet, mund të theksojmë se janë rezultat i kërkesave tona, të cilat duhet të jenë të përcaktuara dhe të shpërndara më drejt, sipas kapaciteteve dhe programeve të studimit për ciklin e parë (tabela 3, figura 2).

Tabela 3. Kuotat e lira për ciklin e parë

Nr.	Fakulteti	% e kuotave të lira
1	Fakulteti i Shkencave Humane	12.11%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

2	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	17.47%
3	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	5.69%
4	Fakulteti i Shkencave të Edukimit	13.04%
5	Fakulteti Ekonomik	15.21%
6	Totali	12.39%




Figura 2. Paraqitja grafike e kuotave të lira sipas fakulteteve

Në programet e studimit sipas fakulteteve, kemi një rritje të cilësisë së pranimeve; janë me notë mesatare mbi 8 rreth 30% e të regjistruarve.

Pothuajse në çdo program studimi ka të regjistruar 15-20 studentë me notë mesatare 7-8 etj.

Universiteti ofron 46 programe studimi të ciklit të dytë (29 programe master profesional dhe 17 programe master i shkencave), të cilat janë të shpërndara pothuajse në vijimësi të programeve të ciklit të parë sipas fakulteteve dhe profileve përkatëse.

Programet e studimit master profesional të mësuesisë për arsimin e mesëm të ulët, janë pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit.

Për të gjitha programet e ciklit të dytë janë bërë ndryshimet dhe përshtatjet në përputhje me Ligjin Nr. 80 /2015, por në zbatim për vitin e ri akademik 2016-2017 (tabela 4).

Tabela 4. Numri i studentëve të regjistruar për programet e ciklit të dytë MP/MSH

Fakulteti	Programi i studimit	MP/MSH	Nr. i st. të regjistruar
-----------	---------------------	--------	--------------------------



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Fakulteti Ekonomik	Ekonomia dhe e drejta në tregjet ndërkombëtare	Msc	12
	Drejtim bankar	Msc	11
	Kontabilitet dhe auditim	Msc	24
	Menaxhim	Msc	18
	Marketing	Msc	16
	Financë	MP	47
	Marketing	MP	15
	Administrim biznes	MP	31
	Kontabilitet	MP	25
	Informatikë Ekonomike	MP	30
	Ekonomia dhe e drejta në sektorin publik	MP	35
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Menaxhim infermieror	MP	114
	Infermieri kirurgjikale	MP	69
	Mami	Msc	50
	Infermieri	Msc	32
Fakulteti i Shkencave Humane	Gjuhësi	Msc	0
	Studime gjeografike	Msc	0
	Gazetar reporter	MP	11
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Mbrojtje mjedisi	Msc	12
	Matematikë e zbatuar	Msc	0
	Teknologjitë e informacionit	MP	51
	Analist prodhimi	MP	0
Fakulteti i Shkencave të Edukimit	AMU matematikë-fizikë	MP	41
	AMU matematikë-informatikë	MP	10
	AMU biologji-kimi	MP	30
	AMU gjuhë frënge	MP	9
	AMU gjuhë angleze	MP	42
	AMU gjuhë italiane	MP	10
	AMU gjuhë gjermane	MP	6
	AMU gjuhë-letërsi shqipe	MP	80
	AMU histori-gjeografi	MP	76
	AMU Edukatë qytetare-histori	MP	0
	AMU Edukatë qytetare-gjeografi	MP	23
	AMU Edukim fizik e sporte	MP	59
	Drejtim administrim arsimit	MP	10
	Psikolog në institucione	MP	25
	Punonjës social	MP	22
	Shërbim prove	MP	21
	Psikolog edukimi	Msc	12
	Shërbime sociale	Msc	31
Arsim fillor	MP	100	
Totali i studentëve sipas kuotave dhe regjistrimeve:		plani 2475, regjistruar 1210	

Realizimi i ngarkesës mësimore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Ngarkesa mësimore është realizuar në përgjithësi sipas kriterëve dhe udhëzimeve përkatëse. Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bërë duke patur parasysh disa kriterë në lidhje me gradat dhe titujt akademikë, fushat e kualifikimit e specializimet etj.

Duhet bërë kujdes për shpërndarjen e ngarkesës gjatë gjithë vitit, sepse ka raste kur ngarkesa për pedagogun përqëndrohet vetëm në një semestër. Rastet e mbingarkesës çënojnë cilësinë e mësimdhënies.

Probleme ka patur në lidhje me realizimin e ngarkesës mësimore në disa disiplina, për disa arsye si mungesa e mjediseve sidomos laboratorëve, por janë kaluar dhe përballuar nga departamentet me orare të zgjatura dhe specifike si dhe duke aktivizuar personel akademik të ftuar dhe me kohë të pjesshme, të cilët realizojnë një ngarkesë mesatarisht nga 80-150 orë (tabela 5, figura 3-9).

Tabela 5. Shpërndarja dhe realizimi i ngarkesës mësimore

Nr	Departamentet	Stafi i brendshëm	Norma	Ngarkesa	Stafi i jashtëm	Ngarkesa	Ore qe duhen mbuluar	Duhen pedagoge
1	Matematikës	13	2980	5192.5	22	2158	4370.5	16.80961538
2	Informatikës	7	1550	3171.5	28	3699	5320.5	20.46346154
3	Biologjisë	11	2230	4683.4	14	1400	3853.4	14.82076923
4	Kimi	8	1860	2695.2	7	807	1642.2	6.316153846
5	Fizika	8	1853	3342.9	16	1400	2889.9	11.115
	FSHN	47	10473	19085.5	87	9464	18076.5	69.525
1	Infermierisë	9	2140	3778.2	39	4445	6083.2	23.39692308
2	Klinike paraklinike	10	2260	5415	63	12182	15337	58.98846154
3	Qendra	8	620	4224.5			3604.5	13.86346154
	FSHMT	27	5020	13417.7	102	16627	25024.7	96.24884615
1	Gjuhës shqipe	10	2120	3736.5	20	1918	3534.5	13.59423077
2	Letersise	13	3150	4411.5	23	2348	3609.5	13.88269231
3	Historise	10	2250	3742.5	22	1936	3428.5	13.18653846
4	Anglisht	20	4920	8460	31	2903	6443	24.78076923
5	Frengjisht	10	2420	4145	34	3518	5243	20.16538462
6	Qendra	6	355	1506.25			1151.25	4.427884615
	FSHH	69	15215	26001.75	130	12623	23409.75	90.0375
1	Psikologjise	8	1810	3435.5	20	2909	4534.5	17.44038462
2	Shkenca Sociale	10	2450	5359	17	2401	5310	20.42307692
3	Metodologjisë	11	2610	4464	9	1156	3010	11.57692308
4	Edukim Qytetar	8	1950	3940	21	2112	4102	15.77692308
5	Edukim Fizik	7	1810	3322.8	21	3075	4587.8	17.64538462
	Qendra	7	670	2704.5			2034.5	7.825
	FSHE	51	11300	23225.8	88	11653	23578.8	90.68769231
1	Administrim biznes	6	1288	2848	15	1740	3300	12.69230769
2	Marketing Inxhinjeri	8	1910	3137.5	12	1121	2348.5	9.032692308
3	Financa	10	2300	4617	17	2040	4357	16.75769231
4	Ekonomiks	9	2250	3819.5	5	625	2194.5	8.440384615
5	Te drejtës	10	2470	4313.5	26	2460	4303.5	16.55192308
	FE	43	10218	18735.5	75	7986	16503.5	63.475
		237	52226	100466.25	482	58353	106593.3	409.9740385



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI




Figura 3. Paraqitja grafike për shpërndarjen e ngarkesës sipas departamenteve

Sqarim: Sasia e orëve që duhet mbuluar është shuma e orëve mbi normë dhe sasia e orëve që mbulohet nga stafi i jashtëm. Pra duhen edhe 409 pedagogë për të mbuluar sasinë e orëve vetëm nga stafi i brendshëm




Figura 4. Paraqitja grafike për shpërndarjen e ngarkesës sipas fakulteteve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI




Figura 5. Paraqitja grafike për shpërndarjen e ngarkesës sipas departamenteve, Fakulteti i Shkencave të Natyrës




Figura 6. Paraqitja grafike për shpërndarjen e ngarkesës sipas departamenteve, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI




Figura 7. Paraqitja grafike për shpërndarjen e ngarkesës sipas departamenteve, Fakulteti Ekonomik




Figura 8. Paraqitja grafike për shpërndarjen e ngarkesës sipas departamenteve, Fakulteti i Shkencave Humane



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI




Figura 9. Paraqitja grafike për shpërndarjen e ngarkesës sipas departamenteve, Fakulteti i Shkencave të Edukimit

Realizimi i ngarkesës mësimore është i lidhur me të gjitha veprimtaritë e personelit akademik (mësimdhënie; kërkim, zhvillim transferim teknologjie; mbështetje për institucionin), prandaj Rektorati dhe njësitë e tjera të Universitetit, në vijimësi kanë vënë në dukje dhe është kërkuar të reflektohet për disa mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

- Pasqyrat të jenë sipas modelit apo formatit të shpërndarë nga Rektorati (Drejtoria e Standardeve dhe Kurrikulave) sipas Udhëzimit nr. 20, datë 09.05.2008.
- Ngarkesat mësimore të personelit akademik të jenë në përputhje me planin mësimor, me programin e lëndës etj.
- Konvertimi i orëve të jetë sipas udhëzimeve përkatëse.
- Të ruhen raportet e veprimtarive për mësimdhënien e normuar me zërat e saj dhe veprimtaritë e tjera, në përqindje dhe në orë.
- Të pasqyrohen saktë datat, temat e mësimin, numri i studentëve etj., në zhvillimin e orës së mësimin.

Niveli i mësimdhënies, kurrikulat dhe kontrolli i njohurive

Edhe në këtë vit akademik në një nivel më cilësor dhe me një përvojë të fituar, u realizua veprimtaria mësimore, në programet e mësipërme të studimit; u hartuan dhe përmirësuan në vijimësi planet dhe programet lëndore, materialet dhe tekstet, temat e diplomave etj.

Rritje cilësore dhe përmirësime në vijimësi ka patur për të gjitha programet e studimit dhe sidomos programet e reja të studimit.

Rektorati dhe strukturat e tjera kanë treguar kujdes për njohjen e studentëve me planet dhe programet lëndore; për pajisjen me tekste, literaturën dhe materiale të tjera mësimore, sipas programeve mësimore, kurrikulave të miratuara, në kohën dhe me procedurën e duhur. Studentët njihen me dokumentacionin mësimor përkatës nga secili pedagog i lëndës në fillim të procesit mësimor, por edhe nga adresat elektronike të UE.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Strukturat e Universitetit dhe Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, vijojnë procesin e monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë për planet dhe programet lëndore.

Standardet shtetërore të cilësisë, përfaqësojnë tërësinë e kërkesave, kriteret që plotëson një institucion dhe shërbejnë si një sërë rekomandimesh që ndihmojnë IAL të arrijë një nivel të caktuar zhvillimi.

Rektorati dhe njësitë e tjera të Universitetit, në vijimësi kanë vënë në dukje dhe është kërkuar të reflektohet për disa mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

- Respektimi i formatit të planit mësimor, i cili duhet të përmbajë elementët kryesorë të përcaktuar sipas akteve nënligjore në fuqi. Mund të themi se fakultetet e kanë respektuar formatin standard.
- Ka probleme për përcaktimin e karakterit të disiplinave, duke e bërë të vështirë identifikimin dhe llogaritjen e krediteve sipas këtyre disiplinave.
- Respektimi i krediteve të përcaktuara për fitimin e diplomave sipas programeve dhe cikleve të studimit.
- Konvertimi i krediteve në orë mësimore, pasqyrimi i saktë i orëve mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale.
- Saktësime për numrin e lëndëve, emërtime të disiplinave dhe moduleve, kodet përkatëse, disiplinat me zgjedhje etj.

Niveli i mësimdhënies dhe standardet e kurrikulave lidhen me cilësinë e **marrjes dhe kontrollit të njohurive**.

Në lidhje me vlerësimin e studentëve si dhe me sistemin e vlerësimit të punës, në vitin akademik 2015-2016 u thellua puna drejt aplikimit të rregullave të reja (*informatizimi i procesit krijon mundësi lehtësuese etj....*).

Zbatimi i rregullores së provimeve ka sjellë përmirësime të dukshme. Ka më pak ankesa dhe thashetheme. Mund të shihen dhe forma të tjera (si p.sh korigjime nga të tjerë të provimit e forma të tjera të larmishme) që mund të përmirësonin në këtë drejtim. Pra, puna me ndërjegje, me kompetencë, në grup me rregulla të qarta, do të na çojë në normalizimin dhe në mbarëvajtjen e provimeve dhe të krejt procesit mësimor. Duhet parë dhe përmirësuar pranimi i kontigjenteve cilësore si dhe rritja e shkallës së kalueshmërisë si nga ana sasiore dhe ajo cilësore (ka ngelje masive dhe të përsëritura në lëndë dhe pedagogë të veçantë).

Personeli akademik dhe kualifikimi i tij

Veprimtaria mësimore realizohet me cilësi nga një personel akademik i kualifikuar. Universiteti ka nxitur dhe mbështetur rekrutimin sipas kriterëve dhe në vijimësi kualifikimin e personelit akademik, duke realizuar tregues dhe raporte cilësore për titujt dhe gradat (tabela 6, figura 10,11).

(Shih formularët e plotësuar nga stafet dhe strukturat në muajin shtator 2016.

1. Formulari i vlerësimit të kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore.
2. Formulari i vlerësimit të infrastrukturës së kërkimit shkencor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Tabela 6. Të dhëna për personelin akademik

Nr.	Titulli, grada	Numri
1	Profesor doktor	18
2	Profesor i asociuar doktor	63
3	Doktor i shkencave	61
4	Docent doktor	4
5	Docent	13
6	Master i shkencave	69
Gjithsej		228





Figura 10, 11. Paraqitja grafike për të dhënat e personelit akademik, titujt dhe gradat

Me tituj dhe grada nga personeli akademik janë **159** vetë ose **69,73%** (figura 12,13).





Figura 12, 13. Paraqitja grafike për të dhënat e personelit akademik, me tituj dhe grada dhe pa tituj dhe grada



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Sipas kategorive klasifikohen (figura 14,15):

Kategoria “Profesorë” janë.....**81 vetë** ose **35,52%**
Kategoria “Lektorë” janë.....**78 vetë** ose **34,21 %**
Kategoria “Asistent-lektorë” janë.....**69 vetë** ose **30,26%**





Figura 14, 15. Paraqitja grafike për të dhënat e personelit akademik sipas kategorive

UE ka personel akademik gjithsej **228** me kohë të plotë dhe rreth **500** me kohë të pjesshme (figura 16,17)





Figura 16, 17. Paraqitja grafike për personelin akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Infrastruktura, kapacitetet mjedisore për veprimtarinë akademike

Universiteti ynë i ka vlerësuar në vijimësi problemet e infrastrukturës mjedisore. Në zbatim të Urdhrit të Sekretarit të përgjithshëm në MAS nr. 362 datë 27.06.2016 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, për vitin akademik 2016-2017”, u vlerësuan treguesit sasiorë dhe cilësorë për secilin fakultet dhe në nivel Universiteti. Treguesit ishin për:

- Strukturën e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan.
- Listën e personelit akademik të Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan.
- Formulari i kapaciteteve sipas fakulteteve.
- Lista e programeve joaktive.
- Tabela e godinave sipas fakulteteve (tabela 7).

Tabela 7. Të dhëna për godinat dhe kapacitetet e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan

GODINA	Pronesia	Nr Katesh	Siperfaqe M2	Nr. Laboratoresh/kapaciteti në vende	Nr.Klasa seminare (Kapaciteti ne vende)	Nr.Klasa leksione, auditore (Kapaciteti ne vende)	Biblioteka- Nr i titujve/ vende leximi	Nr. Boxe H/S per student	Akt Higjieno sanitar Nr. 25	Akt Teknik Mbrojtje nga zjarri
a Korpusi Kryesor Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Shkencave Humane	MAS	2-3-4	7603	29/905	14/550	17/1460	---	34 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 65 datë 04,04,2014
b. Shtëpia e Pritjes	MAS	1-3	575	---	---	---	---	2 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 65 datë 04,04,2014
c. Biblioteka Universitare	MAS	1-3	1680	---	---	---	22200/309	3 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 65 datë 04,04,2014
d. Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike Godina A	MAS	3	1229	2/65	12/443	3/420	---	10 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 62 datë 04,04,2014
e. Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike Godina B	MAS	2	356	1/20	---	2/240	---	2 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 62 datë 04,04,2014
f. Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike Godina C	MAS	3	971	3/140	---	5/420	1000/35	10 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 62 datë 04,04,2014
g. Fakulteti Ekonomik	MAS	2-4	2896	4/120	7/360	11/1090	1000/35	29 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 63 datë 04,04,2014
h. Fakulteti i Shkencave të Edukimit	MAS	3-4	2916	6/245	11/520	11/1190	800/20	22 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 64 datë 04,04,2014
i. Laboratori Metalurgji Fakulteti i Shkencave të Natyrës	MAS	1-2	1841	7/140	---	1/85	---	6 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 66 datë 04,04,2014
j. Palestra	MAS	1	660	2/60	---	---	---	4 boxe	Akt miratimi Higjieno-sanitar Nr. 25 datë 09,04,2014	Akt Teknik Nr. 65 datë 04,04,2014
k. Godina e ish-Maternitetit (në proces rikonstruksioni)	MAS	1-4	1313	---	---	---	---	---	---	---
TOTALI			22040	51/1635	44/1873	50/4905	25000/399	122 boxe		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

Raporti i MAS është pozitiv për këto tregues. Rektorati në strategjinë e vet synon përmirësimin e këtyre treguesve.

Stafet akademike dhe strukturat duhet të kenë gjithmonë ide (projekte) për modernizimin e sallave, laboratoreve dhe t'i paraqesin ato e të ndjekin realizimin e tyre. Porositë për pajisjen e laboratoreve duhet të synojnë të sjellin aparatura të kohës, dixhitale dhe të kompjuterizuara në mënyrë që shpenzimet të jenë të justifikuar dhe të kenë efikasitet maksimal.

Bashkëpunimi i strukturave dhe organeve drejtuese të Universitetit, në nivele rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në veprimtarinë e tyre fakultetet brenda dhe jashtë Universitetit tonë, kanë patur shkëmbime eksperience, diskutime brenda gruplëndëve, diskutime të leksioneve, programeve etj.

Në kuadër të bashkëpunimit midis departamenteve dhe fakulteteve, janë të padiskutueshme dhe me vlerë shumë mendime të dhëna për mjaft nga problemet e ngritura nga Rektorati, Senati, Rektori etj., në lidhje me mbarëvajtjen e punës mësimore dhe jo vetëm. Janë realizuar diskutime dhe janë dhënë propozime për Statutin, Rregulloren e Studimeve, Procedurat e rekrutimit të personelit akademik etj. Kusht për realizimin më cilësor të punës mësimore është padyshim bashkëpunimi më me efektivitet midis strukturave të fakulteteve dhe të Universitetit.

Mjaft i domosdoshëm dhe real ka qënë dhe është bashkëpunimi me pushtetin vendor, komunitetin, institucionet e administrates publike, me shoqatat dhe me bizneset.

Marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet në Evropë dhe pjesëmarrja në projekte, është një nga treguesit e prekshëm dhe konkretë për Universitetin tonë, për vitin akademik 2015-2016 dhe në vijim për vitin akademik 2016-2017.

Në mbledhjen e Senatit, muajin e kaluar, trajtuam nëpërmjet një relacioni informues, procedurat dhe objektivat në lidhje me bashkëpunime të Universitetit "A. Xhuvani" me universitete të tjera; konkretisht shkëmbime të studentëve, të stafit, bashkëpunime për projekte dhe programe në fushën e edukimit dhe kërkimit.

Disiplina e punës

Një tregues i mirë në veprimtarinë akademike është disiplina në punë, por që ka edhe rezerva. Përmirësimi i kushteve drejt një komoditeti sa më të përshtatshëm në mjediset e UE për departamentet dhe fakultetet (bazuar në nevojat dhe kërkesat e tyre), e ka rritur dhe me siguri do të shtojë rendimentin e punës në të ardhmen.



5. Përfundime dhe rekomandime

Ligji i ri për Arsimin e Lartë është një sfidë që duhet të marrë përgjegje nga të gjitha autoritetet drejtuese dhe organet kolegjiale universitare.

1. Viti 2016-2017 për Universitetin e Elbasanit është një vit vendimtar përse i përket krijimit të kuadrit rregullativ dhe institucional për mirëqeverisjen e UE-së, por edhe si detyrim i Ligjit të ri për Arsimin e Lartë.
2. Në të njëjtën kohë ky ligj ka nënvizuar nevojën për t'i dhënë përgjegje sfidave imediate me të cilat Universiteti i Elbasanit ballafaqohet, të tilla si:
 - a. kërkimi shkencor;
 - b. financimi;
 - c. rekrutimi i studentëve;
 - d. bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit gjatë fazës së përgatitjes së akteve nënligjore.
3. Krijimi i disa strukturave të reja që vijnë si rrjedhojë e Ligjit të ri për Arsimin e Lartë si pozicioni i administratorit apo krijimi i Bordit të Universitetit.
4. Hartimi i Statutit të ri të Universitetit të Elbasanit, i cili do të përcaktojë:
 - a. krijimin e disa strukturave kolegjiale, që do të kenë një zë të rëndësishëm në qeverisjen akademike dhe jo vetëm.
 - b. përcaktimi i numrit dhe mënyrës së funksionimit të komisioneve të përhershme që do të ngrihen në nivel fakulteti dhe në nivel senati.
5. Garantimi i burimeve njerëzore duke rritur kështu standardet e mësimdhënies. Përgjegjia ndaj kësaj sfide është e qartë: rritje dhe kualifikim të mëtjshëm të kapaciteteve njerëzore si nga pikëpamja sasiore dhe ajo cilësore.
6. Universiteti ynë duhet të përshtasë kurrikulat mësimore aktuale, të krijojë dhe zhvillojë kurrikula të reja në mënyrë që çdo student i diplomuar të gjejë veten në tregun e punës.
7. Pasurimi i jetës studentore, ku Universiteti ynë do të ridimensionojë hapësirat studentore.
 - a. aftësimin e tyre akademik e profesional.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

- b. zhvillimin e aftësive të tyre dhe talenteve të mbartura.
 - c. krijimi dhe përshtatja e mjediseve të reja, promovimi dhe shpërblimi i talenteve.
- 8.** Ndërkombëtarizimi dhe nevoja për të rritur praninë në arenën ndërkombëtare është e domosdoshme, prioritet dhe njëkohësisht sfidë për Universitetin e Elbasanit.
- 9.** Rritja e rolit/impaktit të Universitetit të Elbasanit në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Përbushja e rolit të institucioneve të arsimit të lartë në përgjithësi edhe UE në veçanti për të plotësuar kërkesat e mësipërme në ditët e sotme, është një sfidë e cila kërkon një vizion të qartë bashkëkohor dhe një drejtim eficient për të përbushur më së miri misionin e tij.

10. Infrastruktura dhe Teknologjia

Universiteti ynë do të synojë përmirësimin e ambienteve aktuale (sallat e mësimin, laboratorët, kabinetet e informatikës, internetit, bibliotekat etj.) duke i pajisur ato me mjetet e nevojshme didaktike, audiovizive e multimediale moderne.

11. Stafi akademik

- Do të rritet numri i pedagogëve në përputhje me normativat që kërkon Ligji i Arsimit të Lartë dhe udhëzimet e tij përkatëse.
- Do të bëhet një shpërndarje e drejtë dhe e ekuilibruar e ngarkesës mësimore në lëndët e një kursi studimi.
- Përdorimi me efikasitet i autonomisë financiare ligjore për të krijuar hapësirat dhe lehtësitat e nevojshme në mbështetje të aktivitetit akademik.

a. Do të rriten në total të ardhurat e pedagogëve, duke garantuar rritje dhe kryerje në kohë të pagesave të aktivitetit mësimor, mbingarkesat dhe orët jashtë orarit.

b. Stafi akademik në realizimin e punës së tij kërkimore dhe mësimore do të mbështetet me fondet përkatëse.

Për këtë, për çdo njësi bazë do të planifikohen në regjistrin e prokurimeve fonde të veçanta, të cilat do të menaxhohen nga vetë departamentet me anë të projekteve konkurruese brenda tyre.

Qëllimi i kësaj mbështetjeje është realizimi me sukses i projekteve kërkimore të stafit akademik si dhe realizimi i tezave të ciklit të dytë, Master i Shkencave.

- c. Krijimi i kushteve për të rritur të ardhurat nga kërkimi, projektet dhe ekspertiza.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

- Do të stimulojmë aktivizimin e stafit akademik në realizimin e shumë projekteve në kuadër të fondeve ndërkombëtare si projektet e Bankës Botërore dhe programet e KE.
- Rritja e mundësive për të publikuar botimet e pedagogëve nëpërmjet bashkëpunimit me bibliotekat elektronike në të cilat do të bëhet abonimi si edhe mbështetja e departamenteve në organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Në mbështetje të stafit të ri akademik, për kualifikimin e tyre, do të planifikohet një fond i veçantë për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, botimin e artikujve shkencorë në revista ndërkombëtare etj.

12. Staf i administrativ

- Staf i administrativ dhe cilësia e shërbimeve që ato ofrojnë do të jenë në fokus të rritjes së cilësisë së shërbimeve që studentët dhe grupet e tjera të interesit marrin nga UE.
 - a. Do të paguhet për të gjitha punët suplementare që kryejnë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore.
 - b. Do të hartohen programe trajnimi në funksion të detyrave që kryejnë.
 - c. Kualifikimi i stafit administrativ në kuadër të projekteve të mobilitetit dhe shkëmbimit të praktikave më të mira do të ndihmojë në realizimin e detyrave administrative në përputhje me zhvillimet më të fundit të teknologjisë së informacionit.

13. Studentët

Fokusi dhe qendra e vëmendjes së Universitetit të Elbasanit do të jetë padyshim Studenti.

Të drejtat dhe kërkesat e studentëve do të jenë prioritet i padiskutueshëm i UE-së në disa drejtime kryesore:

- a. Shtimi i kuotave të pranimit në programet e studimit, në përputhje me standardet.
- b. Përmirësimi i shërbimeve të portalit studentor.

Çdo student i UE-së do të:

- verifikojë notën e tij,
- regjistrohet në provime,
- do të njohë programin e lëndëve,
- do të komunikojë me pedagogët për zgjidhje detyrash, projekte të ndryshme studimi etj.
- c. Mbështetja e strukturave dhe forumeve studentore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI

14. Kërkimi shkencor

Rritja e cilësisë së Kërkimit Shkencor, është gjithashtu një element i rëndësishëm i Ligjit të ri të Arsimit të Lartë.

Disa nga instrumentat që do të përdoren në funksion të përmirësimit të kërkimit shkencor janë:

- a. Mbështetja e ngritjes së qendrave të ekselencës.
- b. Modernizim i infrastrukturës mbështetëse për kërkimin shkencor.
- c. Mbështetje financiare për kërkimin shkencor.

Grupi i punës

Peçi Naqellari
Sotir Mali
Imelda Sejdini
Shkëlqim Hidri
Valentina Haxhiymeri
Albert Riska

Miratoi

REKTORI

Prof.Dr.Skender TOPI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI
